



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 678/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Lista e Pavarur – Bekim Jashari, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të keqpërdorimit të fletëvotimeve, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 20.10.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet** e pabazuar ankesa Anr.678/2021 e datës 18.10.2021, e paraqitur nga Lista e Pavarur – Bekim Jashari, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të keqpërdorimit në vendvotimin nr. 2117B/01R, me kërkesë që të përsëritet votimi në vendvotimin nr. 2117B/01R .

### A r s y e t i m

Me datë 18.10.2021, PZAP, ka pranuar ankesë nga Lista e Pavarur – Bekim Jashari, me të cilën pretendon se: në vendvotimin nr. 2117B/01R, gjatë numërimit të votave nga anëtarët e KVV-së, përmes vëzhguesit të tyre Ukë Ibrahim, është verifikuar që 1 fletëvotim ka qenë i pa vulosura në kutinë e votimit për Kryetar Komune, që lenë shumë dyshime për vjedhje të votave përmes “trenit bullgar”. Gjithashtu kërkon nga PZAP, që të përsëritet votimi në këtë vendvotim.

Në përgjigjen në ankesë të paraqitur nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, me të cilën ka theksuar se: është e pa mundur të ndodh “treni bullgar” , për shkak të identifikimit të fletëvotimit me vendvotim sepse fletëvotimet kane numrin serik unik dhe numrin e vendvotimit të personalizuar dhe nga ana tjetër këshilli i vendvotimit është përbërë nga 5 anëtarë. Gjithashtu thekson se në lidhje me pretendimet e ankuesit PDK, ka pranuar një deklaratë Egzon Kastrati, i cili thekson se sa i përket fletëvotimeve të pa vulosura dhënësi i fletëvotimeve nuk ka qene nga radhët e subjektit politik PDK por nga subjektet rivale, si

dëshmi shtesë ka bashkangjitur edhe raportet nga ekipet monitoruese të KKZ-së në Skenderaj, ku shihet se nuk është regjistruar ndonjë parregullsi, gjithashtu ka bashkangjitur edhe deklaratat e menagjerit dhe kryesuesit të atij vendvotimit.

Në përgjigjen në ankesë KQZ, ka ofruar si dëshmi Librin e Votimit (Librin e Shënimeve në Vendvotim), Listën e Votuesve, si dhe FPR-të.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se: **Ankesa është e pabazuar.**

Paneli, vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me fletëvotimin i cili pretendohet se është verifikuar nga vëzhguesi i tyre Ukë Ibrahim, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli duke u mbështetur edhe në përgjigjen e KQZ-së, nuk mundi të konstatoj faktin se në këtë vendvotim ka pasur ndonjë parregullsi siç pretendon ankuesi, në librin e shënimeve në vendvotimin nr. 2117B/01R të ofruar si dëshmi nga KQZ, nuk është evidentuar se ka pasur ndonjë fletëvotim të pa vulosur, andaj ankuesi nuk e ka dëshmuar me asnjë dëshmi bindëse faktin se ka pasur ndonjë fletëvotim të pa vulosur në këtë vendvotim, siç pretendohet në ankesë.

Andaj, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga Lista e Pavarur – Bekim Jashari, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje në procesin e votimit me datën 17.10.2019, në Vendvotimit 2117B/01R.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
Anr.678/2021 më datën 20.10.2021

**Kryesuesi i Panelit**  
Krustem Thaçi



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.